

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI

Nr/Br. 936120
Datë/Datum. 13.11.20

PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës,
i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA SHTËRPECË**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **655-20-6077-2-1-3**

Sa i përket tenderit për: **Hartimi i Vlerësimit Strategjik të Mjedisit si dhe Hartës Zonale të komunës së Shtërpçës, Komuna e Shtërpçës**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

RR. "SAMI FRASHËRI", Pallati Bjorn, Kati 11

(Adresa)

TIRANË

(Vendi)

1001

(Kodi postar)

+35542260572

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Olset Haxhiu

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

info@ice.al

(Adresa elektronike)

13.11.2020

(Data e parashtrimit të kërkesës)



(Nënshkrimi dhe vulë)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Ky aktivitet i prokurimit ka filluar me rastin e Njoftimit për Konkurs të Projektimit i cili është bërë më datën 08.10.2020.

Hapja publike ishte e paraparë të bëhej me datë 27.10.2020 por nuk ishte bërë me arsyetimin se AK ka pranuar dy oferta në formë fizike dhe një në formë elektronike.

Po ashtu me arsyetimin se ka pasur gabime në dosje të tenderit dhe keq informim të OE, me datë 30.10.2020 AK ka përfunduar procesin e prokurimit duke e anuluar tenderin.

Të pakënaqur me këtë vendim dhe në afat të rregullt kohorë, ne iu kemi drejtohemi AK-së në datën 04.11.2020 me Kërkesë për Rishqyrtim të Njoftimit mbi Vendimin e AK-së.

Me datë 06.11.2020 AK na e ka refuzuar kërkesën për rishqyrtim si të pa-bazuar andaj pakënaqur me këtë vendim dhe në afat të rregullt kohorë, parashtrojmë ankesë pran OSHP-së.

Kriteri i vlerësimit ka qenë tenderi i përgjegjshëm ekonomikisht më i favorshëm (me metodën e poentimit).

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

☐

Jo

☒

Nuk është bërë fare hapja publike edhe përkundër dorëzimit të tenderëve me arsyetimin se ka pasur gabime në dosjen e tenderit dhe si pasojë janë pranuar dy oferta fizike dhe një elektronike.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☐

Jo

☒

Vërejtje: Nuk është bërë fare hapja e tenderëve dhe se tenderi është anuluar pa u bërë fare vlerësimi i tyre.

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Me datë 04.11.2020 kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim pran AK ndërsa me datë 06.11.2020 AK na ka refuzuar Kërkesën për Rishqyrtim si të pabazuar.

Të pakënaqur me vendimin e AK-së për refuzimin të Kërkesës për Rishqyrtim dhe në afat të rregullt kohorë, parashtrojmë ankesë pran OSHP-së.

Vendimin e AK-së për refuzim të kërkesës e gjeni të bashkangjitur.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK gjatë zhvillimit të kësaj procedure të prokurimit nuk ka respektuar ashtu siç duhet dispozitat e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës.

AK nuk ka respektuar as dispozitat e Rregullores dhe Udhëzuesit Operativ të Prokurimit Publik(RRUOPP).

Me këto veprime AK ka shkelur këto dispozita të LPP-së dhe RRUOPP-së:

1. AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së të amandamentuar,
2. AK ka shkelur nenin 62 të LPP-së të amandamentuar,
3. AK ka shkelur nenin 44 të RRUOPP-së,
4. AK ka shkelur nenin 108/A të LPP-së të amandamentuar,
5. AK ka shkelur nenin 43 të RRUOPP-së,
6. AK nuk ka respektuar vendimet dhe njoftimet e KRPP lidhur me formën e dorëzimit të tenderëve.

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Ne vazhdim po ju njohim me faktet dhe argumentet që e mbështesin pretendimin tonë për shkeljet e dispozitave të LPP-së dhe dispozitat tjera nga ana e AK-së.

Pretendimi 1: AK ka shkelur nenin 7 të LPP-së sepse ka bërë trajtim jo të barabartë të OE me rastin e anulimit të tenderit me arsyetimin se disa tenderues kanë aplikuar përmes kopjes fizike. Ky në fakt është diskriminim ndaj kompanisë tonë që e kemi respektuar kërkesën e dosjes së tenderit për dorëzim të ofertës në formë elektronike dhe në të njëjtën kohë është favorizim dhe dhënie e një mundësie të dytë për ata dy OE që kësaj radhe nuk kanë vepruar në përputhje me kërkesat e Njoftimit për Konkurs të Projektimit dhe me kërkesat Fletës së të Dhënave të Tenderit. Bazuar në interpretimin e KRPP-së në të cilin thuhet se baza ligjore për përgatitjen e tenderëve është Njoftimit për Konkurs të Projektimit dhe Fleta e të Dhënave të Tenderit, del që i vetmi OE i përgjegjshme nga aspekti i formës së aplikimit në tenderi jemi ne, kompania Illyrian Consulting Engineers SHPK. Dy kompanitë tjera që kanë aplikuar në formën fizike, nuk e kanë respektuar kërkesën e Njoftimit për Konkurs të Projektimit përkatësisht pikën IV.3.3 si dhe nuk e kanë respektuar as kërkesën e fletës së të dhënave tek pika 20.1.

Përpos kësaj KRPP me vendimin nr. 48/2018 të datës 05.07.2018 i ka njoftuar AK-të dhe OE-të se që nga data 01.09.2018 të gjithë tenderët me vlerë të madhe do të zhvillohen në formë elektronike dhe do të pranohen vetëm ofertat në formë elektronike.

Ja edhe vendimi i tillë:

Në mbështetje të paragrafit 1, të nenit 129 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, dhe në mbështetje të vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 18/140 i datës 05.04.2017 Bordi i KRPP-se merre këtë:

VENDIM

1. Te gjitha aktivitetet e prokurimeve të centralizuara të cilat do të zhvillohen nga Agjencia Qendrore nga data 05.07.2018 (Njoftimet për Kontrate të cilat publikohen në ose pas kësaj date) do të jenë krejtësisht elektronike duke përfshirë edhe dorëzimin e ofertave (nuk do të ketë dorëzimi të ofertave fizike).
2. Te gjitha aktivitetet e prokurimeve me vlerë të madhe të cilat do të zhvillohen nga Autoritetet kontraktuese nga data 01.09.2018 (Njoftimet për Kontrate të cilat publikohen në ose pas kësaj date) do të jenë krejtësisht elektronike duke përfshirë edhe dorëzimin e ofertave (nuk do të ketë dorëzimi të ofertave fizike).

Me këtë vendim i lejohet AQP-se përkatësisht të gjitha Autoriteteve Kontraktuese që në të gjitha aktivitetet e Prokurimit të specifikuar më lart dhe të iniciuara në ose nga datat e cekura më lart të vendosin kushtet dhe të pranojnë nga operatorët ekonomik vetëm ofertat e dorëzuara në formë elektronike.

Gjithashtu më datë 05.09.2018, KRPP prapë e ka publikuar një ri-kujtim lidhur me njoftimin e OE për zbatimin e vendimit 48/2018 lidhur me formën e tenderimit. Ja njoftimi:

NJOFTIM

Në pajtim me Nenin 87, paragrafin 2, dhe nenin 91 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, KRPP nxjerr këtë njoftim për të RI-KUJTUAR të gjitha Autoritetet Kontraktuese dhe Operatorët Ekonomik:

1. Zbatimin e VENDIMIT Nr: 48/2018 të datës 05/07/2018, ku është specifikuar:

Te gjitha aktivitetet e prokurimeve të centralizuara të cilat do të zhvillohen nga Agjencia Qendrore nga data 05.07.2018 (Njoftimet për Kontrate të cilat publikohen në ose pas kësaj date) do të jenë krejtësisht elektronike duke përfshirë edhe dorëzimin e ofertave (nuk do të ketë dorëzimi të ofertave fizike).

Te gjitha aktivitetet e prokurimeve me vlerë të madhe të cilat do të zhvillohen nga Autoritetet kontraktuese nga data 01.09.2018 (Njoftimet për Kontrate të cilat publikohen në ose pas kësaj date) do të jenë krejtësisht elektronike duke përfshirë edhe dorëzimin e ofertave (nuk do të ketë dorëzimi të ofertave fizike).

Me këtë vendim i lejohet AQP-se përkatësisht të gjitha Autoriteteve Kontraktuese që në të gjitha aktivitetet e Prokurimit të specifikuar më lart dhe të iniciuara në ose nga datat e cekura më lart të vendosin kushtet dhe të pranojnë nga operatorët ekonomik vetëm ofertat e dorëzuara në formë elektronike. "

Pra, Operatorët Ekonomik janë të obliguar që për të gjitha procedurat e prokurimit me "Vlerë të madhe" të publikuara nga data 01.09.2018, të dorëzojnë ofertat vetëm në formë elektronike.

Pra bazuar në këtë fakt shihet se arsyetimi i AK-së për anulimin e tenderit është plotësisht i pa-bazuar dhe diskriminim i pastër ndaj kompanisë tonë e cila është e vetmja kompani që e ka respektuar kërkesën e dosjes së tenderit dhe vendimet e KRPP-së.
Kjo konsiderohet shkelje e plotë e nenit 7 të LPP-së mbi trajtimin e barabartë të OE.

Pretendimi 2: AK ka shkelur nenin 62 të LPP-së me rastin e anulimit të këtij tenderi sepse asnjë nga kushtet e parapara në këtë nen nuk janë plotësuar për anulim të tij.
Arsyetimi duket kështu:

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Shtërpçës, pas njoftimit nga anëtarët e Komisioni të hapjes se kanë pranuar dy oferta në formë fizike dhe një ofertë në formë elektronike dhe pas konsultimit të Dosjes së Tenderit dhe Njoftimit për kontrat është vërejtur një gabim teknik në këto dokumente ku theksohet se ofertat duhen të dërzohen në formë fizike por në një vend tjetër thuhet se duhet të dërzohen edhe përmes sistemit. Të gjendur në këtë situat ofertat nuk janë hapur fare andja në përputhje me Ligjin e Prokurimit AK Shtërpçë bënë anulimin e aktiviteti të prokurimit me titull: " Hartimi i Vlerësimit Strategjik të Mjedisit si dhe Hartës Zonale të komunës së Shtërpçës, Komuna e Shtërpçës" me numër prokurimi: 655-20-6077-2-1-3, Numri i brendshëm : 655/20/029/213, të publikuar nga Komuna e Shtërpçës, me datë 07.10.2020 mori këtë:

V E N D I M
MBI ANULIMIN E AKTIVITETIT TE PROKURIMIT

Kjo që ka thënë AK nuk është e qëndrueshme sepse askund në Njoftimin për Konkursin e Projektimit dhe në Dosjen e Tenderit nuk shkruan se tenderët duhet të dorëzohen në formë fizike.

Ja dëshmia se si duket njoftimi për mënyrën e dorëzimit të tenderëve tek Njoftimi për Konkursin e Projektimit:

Dokumentet me pagesë:

Po ☐ Jo ☒

Nëse po, çmimi EUR

Kushtet dhe mënyra e pagesës:

IV.3.3) Afati kohor për pranimin e projekteve / aplikacioneve:

Data 27.10.2020 koha 13:00:00 vendi Përmes sistemit

IV.3.4) Projektet apo kërkesat për pjesëmarrje mund të merren në gjuhën Shqipe, Serbe dhe Angleze.

Ja si duket edhe njoftimi për dorëzim të tenderit tek Dosja e Tenderit – Fleta e të Dhënave të Tenderit:

Afati i fundit i
dorëzimit të tenderit

20.1

Afati i fundit për dorëzim është:

27.10.2020 13:00:00 orë

Vendi: **Përmes sistemit**

Nga kjo shihet se AK ka respektuar në përpikëri vendimin e KRPP 48/2018 për vendosjen e njoftimeve lidhur me mënyrën e dorëzimit të tenderëve mirëpo tani me rastin e këtij tenderi nuk po e respekton procesin e hapjes publike dhe vlerësimin e tenderëve duke tentuar të gjejë shkas për anulimin e tenderit.

Shiko si duket edhe njoftimi shtese i KRPP-së ku iu kërkon AK-ve që ta vendosin njoftimin për formën e tenderimit tek Fleta e të Dhënave të Tenderit përkatësisht tek pika 19.1.h (në dosjet të AK-së 20.1) të cilin AK e ka respektuar plotësisht por që tani për qëllime favorizimi dhe dhënie të mundësisë për ri-tenderim të OE-ve që kanë aplikuar në formën fizike, nuk po e respekton dhe nuk po e bënë hapjen publike.

Ja njoftimi i KRPP i datës 05.09.2018 që iu drejtohet AK-ve dhe OE.

Datë: 05.09.2018

Të nderuar,

Ne mbështetje të vendimit të KRPP-se, Nr: 48/2018 (i nxjerre në baze të vendimit të Qeverisë së Kosovës Nr:18/140 date 05.04.2017) dhe ne mbështetje të ndryshim/plotësimit të RROUP të datës 03.09.2018, KRPP rikujton të gjitha Autoritetet Kontraktuese dhe Operatorët Ekonomik (ofertuesit) se nga data 03.09.2019 janë të obliguar të zbatojnë vendimin dhe ndryshim plotësimet e RRUOP si me poshtë;

- Te gjitha aktivitetet e prokurimeve me vlerë të madhe të cilat do të zhvillohen nga Autoritetet kontraktuese nga data 01.09.2018 (Njoftimet për Kontrate të cilat publikohen në ose pas kësaj date) duke përfshirë edhe dorëzimin e ofertave do të jenë krejtësisht elektronike (nuk do të ketë dorëzimi të ofertave fizike).
- Autoritetet Kontraktuese për të gjitha procedurat me vlerë të madhe duhet të cekin në Njoftimet për kontrate dhe FTD të Dosjes së Tenderit, nën 19.1.h, që tenderi të dorëzohet vetëm “në mënyrë elektronike” (në asnjë mënyrë në versionin tjetër). Përveç kësaj AK do t'i kushtoj vëmendje të shtuar njoftimit/informimit të OE edhe në mënyra tjera, se OE duhet të dorëzojnë ofertën e tyre vetëm në mënyrë elektronike sepse kjo do të jete kusht i tenderit i cili duhet respektuar për të mundësuar pranimin e ofertës si të “përgjegjshme” administrativisht.

Tani po ua paraqesim edhe dëshminë e respektimin i këtij vendimi nga AK kur në Fletën e të Dhënave të Tenderit e ka vendosur shumë qartë këtë njoftim vetëm se numrin rendor në vend të 19.1 e ka lënë 20.1.

Dokumentet që përbëjnë Koncept Projektin	18.1 (a)	Shëno kërkesa tjera për prezantimin e projektit, p.sh. metoda elektronike		
Afati i fundit i dorëzimit të tenderit	20.1	Afati i fundit për dorëzim është: 27.10.2020 13:00:00 orë Vendi: Përmes sistemit		
Vlerësimi i Koncept Projekteve	23.1	Kriteret, nën-kriteret, dhe sistemi i pikëve i cili do të përdoret për vlerësimin e Koncept Projekteve janë:		
			Nën-kriteret	Pesha në %
			Propozimi financiar	1.) Koncepti i Zonimit

Pra pas gjithë këtyre sqarimeve nuk kemi se si të mos mendojmë ndryshe se arsyetimi i AK-së për anulimin e tenderit është i pa bazuar sepse askund në Njoftimin për Konkursin e Projektimit dhe në Dosjen e tenderit nuk thuhet se dorëzimi i tenderit duhet të bëhet në formën fizike. Bazuar në këtë shihet se AK nuk e ka respektuar fare nenin 62 të LPP për mundësit e dhëna lidhur me anulimin e tenderit.

AK ka përdorur dosjen standarde të publikuar nga KRPP dhe askund nuk ka bërë ndryshime tjera përpos në fletën e të dhënave. Me që tenderët përgatiten duke u bazuar ekskluzivisht në Fletën e të Dhënave të Tenderit dhe aty shumë qartë shkruan se tenderët dorëzohen përmes sistemit, e forcon edhe më shumë faktin se AK ka vepruar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së kur e ka anuluar tenderin. AK në arsyetimin për anulim të tenderit por edhe në arsyetimin për refuzim të Kërkesës për Rishqyrtim nuk ka dhënë ndonjë sqarim detal se ku shkruan diku tjetër në dosje që tenderët duhet të dorëzohet në formën fizike. Bazuar në këtë del që arsyetimet e tilla janë plotësisht të pabazuara ndërsa anulimi është në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së ndërsa Refuzimi i kërkesës tonë është në kundërshtim me nenin 108/A të LPP-së.

Pretendimi 4: AK ka shkelur nenin 44 të RRUOPP-së pasi që ka anuluar tenderin në kundërshtim me të gjitha mundësit e dhëna tek ky nen. Ja mundësit që i jep ky nen për anulim të tenderit para hapjes publike të ofertave:

44.7 Procedura e prokurimit para hapjes së ofertave mund të anulohet për arsye të mëposhtme:

- (i) për shkak të ngjarjeve të demonstrueshme dhe / apo arsyeve që janë jashtë kontrollit të AK dhe se nuk ishin të parashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve;
- (ii) nëse AK gjatë pergaditjes dhe udhëheqjes së procedurës ka përdorur gabimisht opcionin për procedurën përkatëse dhe i cili gabim me verifikim të KRPP-se është i pariparueshëm;
- (iii) është paraqitur një gabim teknik në platformën e prokurimit elektronik nga ndonjë situatë e paparashikuar, brenda kontrollit dhe domenit të KRPP-se dhe jashtë kontrollit të AK dhe i cili gabim është i pariparueshëm sipas verifikimit dhe konstatimit nga KRPP;
- (iv) nëse është paraqitur pamundësia e përdorimit të platformës elektronike nga të gjithë përdoruesit si pasojë e problemeve teknike jashtë kontrollit dhe domenit të KRPP-se dhe AK, dhe verifikimit e konstatimit nga KRPP-ja.

Shihet qartë se tek rasti jonë asnjëri nga këto mundësi nuk është plotësuar andaj anulimi i tenderit është bërë në kundërshtim të plotë me nenin 44 të RRUOPP-së dhe në kundërshtim të plotë edhe me dispozitat tjera të rregullores që flasin për me formën e dorëzimit të tenderëve dhe për mënyrën e zhvillimit të procedurave të prokurimit.

Pretendimi 5: AK ka shkelur nenin 108/A të LPP-së pasi që gjatë shqyrtimit të Kërkesës për Rishqyrtim nuk ka dhënë arsye të detajuara lidhur me refuzimin e kërkesës tonë ashtu siç e kërkon paragrafi 8 dhe 10 i këtij neni.

Përpos kësaj AK nuk e ka respektuar as nenin 108/A.3.3 të LPP sepse nuk ka pritur 5 ditë për ndonjë Kërkesë për Rishqyrtim por me datë 04.11.2020 ka publikuar Formularin **B10-Njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit**.

Kjo bie ndesh edhe me nenin 43.3 të RRUOPP-së i cili shumë qartë e tregon afatin e pritjes për ankesë pas çdo njoftimi për vendimin e AK-së.

Pra bazuar në krejt këtë, shihet qartë se AK nuk ka respektuar as nenin 108/A të LPP-së.

Pretendimi 6: AK nuk ka respektuar vendimet dhe interpretimet e KRPP-së të cilat janë publikuar disa here në web-faqes së KRPP-së dhe në e-prokurim ku shumë qartë thuhet se pas datës 01.09.2018 të gjitha ofertat duhet të pranohen në formën elektronike dhe ato që dorëzohen në formën fizike duhet të konsiderohen të papërgjegjshme. Të gjitha këto vendime po ia bashkëngjisim kësaj kërkesë për rishqyrtim por të njëjtat mundeni ti gjeni edhe tek web-faqja e prokurimit elektronik.

Pas gjithë këtyre sqarimeve dhe fakteve të ofruara shpresojmë dhe besojmë se OSHP do ta shqyrtoj me kujdes kërkesën tonë për rishqyrtim të vendimit të AK-së dhe njëherit do ta aprovoj si të bazuar, duke marrë,

V E N D I M

APROVOHET si e bazuar Ankesa e OE “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS” lidhur me tenderin “Hartimi i Vlerësimit Strategjik të Mjedisit si dhe Hartës Zonale të komunës së Shtërpçës, Komuna e Shtërpçës” i iniciuar nga KOMUNA E SHTRËPCËS

ANULOHET vendimi i AK-së për anulimin e aktivitetit të prokurimit dhe lënda të kthehet ri-vlerësim.

Ri-vlerësimi të bëhet bazuar plotësisht në kërkesat e dosjes së tenderit ku pas hapjes së ofertave sipas njoftimit dhe vlerësimit të tyre sipas kërkesave të dosjes, **Fitues** do të duhej të shpallej OE “ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS SH.P.K.”














9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Dëmet materiale që na shkaktohen nëse ne nuk e marrim këtë kontratë janë të konsiderueshme si në fushën financiare, fitime të munguara, dhe mos mundësi e kompensimit të shpenzimeve përgatitore për këtë kontratë. Po ashtu kemi edhe dëmtim të reputacionit si një kompani serioze, me një përvojë të madhe në këtë fushë.

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

-  1 Njoftim per Konkursin e Projektimit
-  2 Template per Dosja e Tenderit Shqip
-  3 Parmasa Hartimi i Vlerësimit Shtërpçës
-  4 Njoftim mbi Vendim e AK - Anulimi i Aktivitetit
-  5 Dosja e Konkursit te projektimit - Procedur e Hapur - Standarde nga sistemi
-  6 Njoftim Vendim Per AK dhe OE nga KRPP
-  7 Njoftim_Rikujtim per AK dhe OE nga KRPP
-  8 Njoftim per AK dhe OE nga KRPP
-  9 NJOFTIM RI-KUJTUES nga KRPP
-  10 Dëshmi e dorezimit te tenderit ne form elektronike ICE SHPK
-  11 B10 Njoftimi per anulimin e aktivitetit te prokurimit 03.11.2020
-  12 Kërkesë për Rishqyrtim nga ILLYRIAN CONSULTING ENGINEERS 04.11.2020
-  13 Vendimi per refuzim te Kerkeses per Rishqyrtim - 06.11.2020

Vërejtje: Përpos këtyre dëshmime AK posedon edhe të gjitha dëshmitë e nevojshme në dosjet e kësaj procedure të prokurimit.